

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **QENDRA E STUDENTEVE**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **208/90500-26-711-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me material higjenik për nevoja e Qendrës së Studentëve**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Sonat Group SH.P.K.
NUI	812075621
Adresa	Prishtine
Vendi	Prishtine
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Eris Hajdari
Adresa elektronike	Sonatgroupshpk@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	18.08.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit	Dr. Sc. ILAZ DULI - Ekspert i Lartë Ndërkombëtar i Prokurimit
Adresa e plotë	Rr. "Omer Nishani"; PN; 10.000 Prishtine
Numri i Telefonit	+ 383 44 430 785
Numri i faks-it	
Adresa elektronike	ilaz_duli@hotmail.com

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me material higjenik për nevoja e Qendrës së Studentëve

Furnizim me material higjenik për nevojat e Qendrës së Studentëve

- ? **Njoftimi për kontratë: 18.03.2026**
- ? **Afati për dorëzim të tenderit: 28.04.2026**
- ? **Kriteret e dhënies: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët;**
- ? **Vlera e Kontratës: Kontrate me vlere të madhe**

Kontratën Publike Kornizë - Furnizim për 36 muaj

- ? **Procesverbal i hapjes së ofertave: 28.04.2026**
- ? **Njoftim i parë mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues:**
- ? **Ankesa nga OE “N.T.SH. GIPA” në OSHP: 03.06.2026**
- ? **Rekomandimi i Ekspertit Shqyrtues: 17.06.2026**
- ? **Vendimi i OSHP- Paneliste Individuale: 03.07.2026**
- ? **Njoftim i dytë mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues: 03.08.2026**
- ? **Letër Standarde për Tenderuesin e Eliminuar: 03.08.2026**
- ? **Kërkesa për Rishqyrtim: 08.08.2026;**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

- ? **Hapja në mënyre elektronike e ofertave është bërë me 28.04.2026**
- ? **Nuk kemi marrë pjesë në hapje elektronike të ofertave**
- ? **Kemi pranuar procesverbalin e hapjes së tenderëve në formë elektronike**

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Me datën 08.08.2026 kemi bërë Kërkesë për Ri-shqyrtim pranë AK - Qendra e Studenteve

Me 12.08.2026, kemi pranuar Vendimin për Refuzimin e Kërkesës për Ri-shqyrtim, ku ceket:

Refuzohet e pabazuar Kërkesa për Rishqyrtim e Konsorciumit “SONAT GROUP” SHPK & Ananas SHPK” lidhur me aktivitetin për Furnizim me material higjienik për nevojat e Qendrës së Studentëve”, me Nr. të Prokurimit: 208/90500-26-711-1-1-1.

Ne refuzimin e Kërkesës për Ri-shqyrtim, AK - Qendra e Studenteve, pasi i përmend të gjitha nenet e cekura në Kërkesën tone për Ri-shqyrtim, përpiqet të arsyetojë shkeljet e bëra në këtë aktivitet të prokurimit, duke ofruar përgjigje me citimin e neneve të LPP dhe Rregullores për Prokurim Publik, gjë që ne mendojmë se këto arsyetime janë të pa qëndrueshme kur të kihet para sysh QËLLIMI parësor i LPP: Të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike.

Sipas Vendimit të Panelit Shqyrtues OSHP: 2026/0359 të datës 03.06.2026, i cili bazohet në Opinionin e KRPP Nr. 11 të datës 09.06.2026, të gjetjet e Panelit Shqyrtues në Fjalinë e fundit të këtij Paragrafi në faqen 16 ceket: ANDAJ PER PSH KY PRETENDIM ANKIMOR KONSIDEROHET I BAZUAR, NGASE GJATE VLERËSIMIT TË OFERTAVE NUK KA VEPRUAR NË PËRPUTHJE ME NENIN 59 TË LPP-së DUKE KËRKUAR DËSHMI TË TJERA SI SHEMBULL TRANSAKSION BANKAR.

Ky ishte i vetmi pretendim ankimor i cili ishte gjetur i bazuar nga Paneli Shqyrtues. Duke u bazuar në këtë gjetje të Panelit Shqyrtues, AK - Qendra e Studenteve i ka kërkuar sqarime Konsorciumit “SONAT GROUP” SHPK & Ananas SHPK për transaksionet bankare.

Konsorciumi “SONAT GROUP” SHPK & Ananas SHPK, ka dërguar transaksionet bankare të përmbledhura në mënyrë kumulative, të cilat e kanë arritur vlerën e kërkuar në Dosje të Tenderit. Qendra e studenteve nuk i ka pranuar transaksionet e përmbledhura por është bazuar vetëm në ato individuale - të veçanta ku në kartele gjatë filtrimit nuk janë përfshirë të gjitha. (Kjo situatë është shtjelluar më poshtë) .

Duke mos i pranuar transaksionet e përmbledhura si dhe duke mos kërkuar sqarime të mëtutjeshme për argumentimin e transaksioneve bankare individuale AK - Qendra e studenteve ka vepruar edhe në kundërshtim në Nenin 116, Paragrafi 6 të LPP, dhe Nenin 67.7 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik ku ceket: Një vendim i OSHP-se për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.

Edhe pse AK - Qendra e Studenteve nuk ka kërkuar sqarime shtese të mëtutjeshme patjetër është dashur këtë devijim në ofertën tone ta klasifikojë si devijim JO-SUBSTANCIAL, kështu që në asnjë aspekt AK nuk kishte me të kundërshtim me Nenet 1, 6, 7, 59, dhe 72 të LPP, me Nenet 4 dhe 9 të Rregullores për Prokurimin Publik, si dhe Nenin 10 të Udhëzuesit për Prokurimin Publik në fuqi.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet janë:

- *Neni 59 i LPP Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve - Paragrafi 1 dhe Paragrafi 4*
- *Neni 4, Paragrafi 3 dhe Neni 45.19 dhe 45.22 i Rregullores për Prokurimin Publik (Versioni i konsoliduar),*
- *Neni 72 të LPP - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë*
- *Neni 10 i Udhëzuesit Nr. 002/2024, për Plotësim Ndryshimit të Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik*
- *Neni 1 Qëllimi i Ligjit*
- *Neni 6 dhe 7 i LPP*

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK - Qendra e Studenteve me datën 18.03.2026 ka publikuar Njoftimin për kontratë për Aktivitetin e Prokurimit: Furnizim me material higjienik për nevojat e Qendrës së Studentëve”, me Nr. të Prokurimit: 208/90500-26-711-1-1-1

Ne ditën e hapjes së ofertave me 28.04.2026, ofertat i kanë dorëzuar 6 operatorë ekonomik, kurse oferta me çmim më të lirë ishte oferta e jone në vlerë prej 162,830.00 €, e qe ishte

Konzorciumi “SONAT GROUP” SHPK & Ananas SHPK si pale e interesuar për këtë aktivitet të prokurimit ka ofruar çmimin më të lirë për 35,547.12 €, apo 21.83 % më të lirë

se sa oferta e propozuar për Dhënie të Kontratës me datën 04.08.2026, TEKNIKA SHPK e cila ka ofertua me çmim prej 198,377.12 €. Kriteri për Dhënie të Kontratës ka qene Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët, kurse AK - Qendra e Studenteve neve na eliminon duke na klasifikuar te papërgjegjshëm ne te vetmen arsye, sipas Formularit B42 - Letër standarde për Tenderuesin e Eliminuar, ku ceket:

AK - Qendra e Studenteve me rastin e eliminimit të ofertës sonë ka bere një vlerësim jo te drejte te ofertave, duke mos i dhënë asnjë rëndësi shfrytëzimit sa me ekonomik dhe me racional te buxhetit te Qendrës se Studenteve, por duke bere përpjekje qe te gjeje devijime qe nuk mund te konsiderohen aspak substanciale, dhe duke dëmtuar buxhetin e AK për 35,547.12 €, apo 21.83 % ne këtë aktivitet te prokurimit.

Arsyetimi i AK se nuk keni arritur te dëshmoni përmbushjen e Kërkesës Nr. 1 te Kapacitetit teknik dhe profesional ne vlere jo me pak se 300,000.00 € siç kërkohet ne DT, nuk është i qëndrueshëm dhe mund te konstatohet qe është i qëllimshëm vetëm për eliminimin e ofertës tone. Te anëtarit i konzorciumit Sonat Group SHPK vlere e transaksioneve është 188,330.18 €, kurse te ANANAS SHPK, vlere e transaksioneve bankare janë 150,687.60 €, qe te dyja se bashku arrijnë vlerën prej 339,017.78 €, qe është me e madhe se vlere e kërkuar ne Dosje te Tenderit. Te Ziraat Bank, totali i transaksioneve është 150,687.60 €, kurse transaksionet e veçanta gjate filtrimit nuk janë përfshirë te gjitha. AK është dashur te bazohet ne totalin e transaksioneve ose te kërkojë sqarime shtese, duke u bazuar ne Nenin 72, te LPP - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, ku ne Paragrafin 3 shume qarte ceket: Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Edhe pse totali i transaksioneve ka përmbushur Kërkesën ne DT, AK para se te eliminon ofertën tone ka qene e obliguar qe te përmbushë këtë kërkesë te paragrafit 3 te Nenit 72 te LPP, pasi qe te gjitha këto informata kane qene te ndodhura dhe te fiksuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, gjë qe kjo informate verifikohet në mënyrë objektive.

Neni 6 i LPP - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, Paragrafi 1, ku ceket: Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Ky paragraf e obligon AK - Qendrën e Studenteve detyrimisht qe Fondet publike te i shfrytëzon në mënyrën më ekonomike, ne rastin konkret duke i kursyer 35,547.12 €, apo 21.83 % te buxhetit ne krahasim me ofertën e propozuar për Dhënie të Kontratës

Te njëjtin veprim nga AK - Qendra e Studenteve e kërkon edhe Neni 38 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik - Sqarimi i Tenderëve, ku ne Paragrafët 2 dhe 3 ceket shume qarte: Paragrafi 2: Megjithatë, lejohet qe një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të

kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Paragrafi 3: Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve.

Edhe Udhëzues Nr. 002/2024, për Plotësim Ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, e obligon AK - Qendra e Studenteve me qellim të kursimit dhe shfrytëzimit me ekonomik të buxhetet para se të eliminojë një ofertues të kërkon sqarime: Neni 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve i këtij Udhëzuesi i përcakton shembujt kur AK varësisht nga rasti i paraqitur duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së: "Lista e kontratave të realizuara nuk është dorëzuar por janë dorëzuar deshmite(referenca/certifikata e pranimit/kontrata) Mund të kerkohen informata sqaruese sipas 69"

Ne rastin konkret ne ofertën e Konzorciumit "SONAT GROUP" SHPK & Ananas SHPK, nuk kane munguar informatat e cekura por ato kane qene te përmbledhura ne mënyrë kumulative, prandaj Qendra e Studenteve sipas kërkesave te te gjitha Neneve te lartcekura te LPP, Rregullores dhe Udhëzimit për Prokurim Publik ka qene e detyruar qe te kërkon informatat sqaruese çdo here me qellim të shfrytëzimit me ekonomik të buxhetet te AK para se të merre vendimin për eliminimin e ofertës me të lire të Konzorciumit "SONAT GROUP" SHPK & Ananas SHPK.

AK - Qendra e Studenteve me rastin e Rivlerësimit të Ofertave sipas Vendimit të OSHP nuk ju ja përmbajtur Nenit 116, Paragrafi 6 të LPP, si dhe Nenit 67.7 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik ku ceket: Një vendim i OSHP-se për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.

Ne rastin konkret AK - Qendra e Studenteve me rastin e eliminimit të ofertës së Konzorciumit "SONAT GROUP" SHPK & Ananas SHPK, ka shkelur substancialisht këto dispozita LPP ne fuqi, Rregullores për Prokurim Publik Nr. 01/2022, si dhe

Udhëzuesit Nr. 002/2024, për Plotësim Ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik.

Qendra e Studenteve shkeljen me te rende e ka bere duke mos marre pare sysh fare mundësitë për te cilat e obligon Neni 59 i LPP - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve - Pika (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Argumentimin për eliminimin e ofertës sonë pa mbështetje bindëse ligjore e forcon edhe Neni 45.19 i Rregullores për Prokurimin Publik, ku ceket shumë qartë: Neni 59.4 i LPP-së gjithashtu lejon autoritetin kontraktues që të pranojë ofertat, në raste të gabimeve ose paqartësive dhe në raste të devijimeve të vogla. Në të dyja rastet është një kusht që aspektet materiale të njoftimit për kontratë/dosjen e tenderit nuk janë prekur.

Neni 45.22 i Rregullores për Prokurimin Publik (Versioni i konsoliduar), me qellim te shfrytëzimit ne mënyrë sa me ekonomike te buxhetit i mundëson AK te kërkoj sqarime te ofertës pa bere asnjë shkelje substanciale te dispozitave ligjore kur ceket: Sipas nenit 59.2 të LPP-së, autoriteti kontraktues mund të kërkojë qartësimin e çfarëdo aspekti të tenderit nga Operatori përkatës ekonomik me shkrim.

AK - Qendra e Studenteve gjate vlerësimit te ofertave për këtë tender nuk e ka marre fare parasysh Nenin 72 te LPP - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, te 3 paragrafëve ku ceket:

Paragrafi 1: Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

Paragrafi 2: Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji

Paragrafi 3: Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Kur është ne pyetje kursimi i buxhetit te AK - Qendra e Studenteve, nuk ka mundur te klasifikojë arsyet per eliminimin e ofertës tone si devijime substanciale, sepse devijim shume me substancial është shpenzimi i buxhetit me shume për 35,547.12 €, apo 21.83 %, ne krahasim me ofertën e shpallur fituese.

Neni 59 i LPP - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, ne paragrafin 1 ceke: Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Për vlerësimin e tenderit ne fjale të gjitha anëtarët e komisionit vlerësues do te jene përgjegjës për vlerësimin jo te drejte te këtij tenderi dike e dëmtuar AK për 21.83 %, për devijime tepër jo substanciale

Vlen te theksohet se OSHP me rastin e nxjerrjes se vendimit te datës 03.07.2026 ka vepruar ne kundërshtim me Nenin 21, Paragrafi 5.2 te Rregullores se Punës së OSHP Nr. 01/2020, duke nxjerrë vendimin vetëm nga Paneliste Individuale:

5. Kryetari emeron panelin prej tre anetareve per keto raste:

5.Kur kemi te bejme ne vleresimin e kriterëve diskriminuese gjate fazes se tenderimit, ose

5.2 Kur vlere e lendes se ankeses per aktivitetin e prokurimit eshte mbi 30,000.00 euro(tirdhjete mije euro) dhe jo me madhe se 500,000.00 euro(peseqind mije euro)

AK - Qendra e Studenteve gjate eliminimin e ofertës tone ka bere shkeljen edhe te këtyre neneve te LPP:

- *Neni 1 Qëllimi i Ligjit, Paragrafi 1: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Eliminimi i konzorciumit tonë me çmim me te ulte për 21.83 %, për devijime tepër jo substanciale është ne kundërshtim te plote me qëllimin parësor te LPP i cili kërkon nga çdo AK të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike.*

- *Neni 6 i LPP - Ekoniciteti dhe Efikasiteti, Paragrafi 1: Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.*
- *Ne këtë aktivitet të prokurimit AK - Qendra e Studenteve ka dëmtuar buxhetin duke eliminuar ofertën tone me çmim më të lirë për 35,547.12 €, apo 21.83 % në këtë aktivitet të prokurimit.*
- *Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi, Paragrafi 1 ku ceket: Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

Gjithashtu AK - Qendra e Studenteve gjatë zbatimit të këtij aktiviteti të prokurimit, ka vepruar në kundërshtim me Nenin 4, Paragrafi 3 i RrPP, i cili kërkon:

- *Të gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim:*
 - a. *Konkurrenca – në mesin e Operatorëve Ekonomik duhet të inkurajohet në mënyrën më efektive dhe me efektive.*
 - b. *Efikasiteti & Efektiviteti – duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për paratë për Autoritetin Kontraktues.*
 - c. *Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial. Të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.*
 - d. *Objektivitet/Integritet/Sinqeritet – Të deklarohet çdo konflikt i interesit që afekton ose paraqet afektim të vendimit; Të refuzohen dhuratat, mikpritje dhe benefite të çfarëdo lloji nga Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial, të cilat mund të paraqesin kompromitim të objektivitetit ose integritetit.*
 - e. *Transparenca – Të sigurohen kushte dhe qasje të barabartë për të gjithë OE-të, duke informuar ata në mënyrë të hapur dhe transparente.*
 - f. *Llogaridhënie – Të ketë llogaridhënie për përgjegjësitë e përcaktuara, si dhe për vendimet e nxjerra, dhe regjistrimin e të dhënave të nevojshme.*

Profesionalizëm – Të punohet me standarde të larta profesionale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikën më të mirë

Duke u bazuar ne te dhënat e cekura me larte, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP:

- *Te shqyrton te gjitha pretendimet e ANKESES, te bien Vendimin meritor duke u bazuar ne faktet dhe argumentet e paraqitura me larte, si dhe te kërkon nga AK te bene RI-VLERESIMIN e këtij Tenderi, si dhe eliminimin e shkeljeve te bëra gjate vlerësimit te këtij aktiviteti te prokurimit;*
- *Me rastin e RI-VLERESIMIT te kërkon nga AK - Qendra e Studenteve qe te merre ne konsiderate te veçantë sidomos Nenin 6 dhe Neni 59, Pika (ii) të LPP.*

Duke pasur një besim te plote ne Panelin Shqyrtues të OSHP, shpresojmë se ANKESA e jone do te vlerësohet drejte, kurse Paneli Shqyrtues te nxjerre ne vendim te arsyeshëm ne përputhje me Nenin 1 te LPP: Qëllimi i Ligjit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet kryesore te cilat i janë shkaktuar Konzorciumit “SONAT GROUP” SHPK & Ananas SHPK janë:

- ? **Mohimi i te drejtës për ta fituar tenderin ne fjale, përkundër plotësimit te kërkesave ne përputhje me dosjen tenderike, me një devijim te vogël jo-substancial;**
- ? **Ulja e kredibilitetit te kompanisë sonë**
- ? **Shpenzimet e resurseve humane dhe financiare për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës;**
- ? **Ngarkesat psikike dhe shqetësimet te cilat ne vazhdimësi na përcjellin me rastin e padrejtësive qe na ka shkaktuar AK – Qendra e Studenteve, me rastin e refuzimit te ofertës tone;**
- ? **Humbja e besimit për te tenderuar ne aktivitetet tjera te prokurimit, edhe me këtë zvogëlimin e konkurrencës dhe mos-arritjen e vlerës për para nga ana e AK – Qendra e Studenteve, si parimin me te rëndësishëm te prokurimit publik.**

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) *një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*

- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.